



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 126

Tiranë – E martë, 21 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 73/2015 datë 9.7.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” 6649
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 15.7.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” 6650
Urdhër i ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 101, datë 17.4.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, të ndryshuar..... 6652
Vendim i Auroritetit të Mediave Audiovizive nr. 57, datë 10.7.2015	Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim” 6653



LIGJ
Nr. 73/2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 107/2014 “PËR
PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E
TERRITORIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Hapësira publike

1. Hapësira publike është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

2. Autoritetet publike, kryesisht ose në partneritet me sektorin privat, krijojnë hapësirë publike përmes ndërtimit të infrastrukturave publike, të përcaktuara në nenin 3, të ligjit nr. 107/2014, për gjelbërimin, transportin, aktivitetet sociale, edukativo-sportive, çlodhëse dhe/ose krijuese, sipas rregullave, kushteve dhe standardeve të posaçme.

3. Autoritetet vendore të planifikimit kanë detyrimin të sigurojnë mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e hapësirave publike, me shpenzimet e veta, përfshirë në pronë private, pa cenuar të drejtën e pronarëve për zhvillimin e tyre deri në momentin e kryerjes së zhvillimit.

4. Në hapësirat publike lejohen të kryhen

vetëm aktivitete që janë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre.

5. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, rregullat, kushtet dhe procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.”.

Neni 2

Në nenin 6, pika 6, shkronja “b”, bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “dhe marrëdhëniet e tyre të punës” zëvendësohen me fjalët “të punonjësve të kësaj agjencie”.

2. Në fund të kësaj shkronje shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 3

Në fund të nenit 7 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“2. Pranë Këshillit Kombëtar të Territorit funksionon sekretariati teknik i këtij këshilli, i cili ka përgjegjësi:

a) për të organizuar mbledhjet e KKT-së;

b) për të përgatitur dokumentacionin që shqyrtohet në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit;

c) për të administruar dokumentacionin e sipërpërmendur.

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e strukturës që do të veprojë si sekretariat teknik, numrin e punonjësve, nivelet e pagave e të shpërblimit dhe marrëdhëniet e tyre të punës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.”.

Neni 4

Në nenin 9, pika 4 shfuqizohet.

Neni 5

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Delegimi i përgjegjësive

1. Autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit mund t’u delegojnë organeve në



varësi përgjegjësi të caktuara për planifikimin e territorit.

2. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund t'i delegojnë, me marrëveshje, njëra-tjetrës përgjegjësi dhe funksione të caktuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit.

3. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund të kontraktojnë kryerjen e shërbimeve të ndryshme për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ose mund t'i kryejnë ato bashkërisht në marrëveshje mes tyre.”.

Neni 6

Pas nenit 45 shtohet neni 45/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 45/1

Kushti për përshtatshmërinë e mjedisit

1. Të gjitha ndërtimet për banesa, hapësira dhe shërbime për publikun, përfshirë parqet, sheshet dhe rrugët, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kërkesat dhe standardet e përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sipas dispozitave të përcaktuara në rregulloren për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

2. Përshtatshmëria e ndërtimeve të reja apo në proces rikonstruksioni, si më sipër, është kusht për marrjen e lejes së ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit të Territorit.

3. Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.”.

Neni 7

Dispozitë kalimtare

Deri në krijimin dhe nisjen e funksionimit të strukturës së sekretariatit teknik të KKT-së, funksionet e këtij sekretariati do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Neni 8

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të tij.

Faqe | 6650

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9184, datë 20.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 632, datë 15.7.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 108, DATË 9.2.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR AFTËSITË QË DUHET TË PLOTËSOJNË PUNËMARRËSIT, PERSONAT DHE SHËRBIMET E SPECIALIZUARA, QË MERREN ME ÇËSHTJET E SIGURISË DHE TË SHËNDETIT NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 7, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:



i) Fjalja hyrëse e pikës 10 dhe pika 10.1 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Personi i ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë është përgjegjës:

10.1 për të marrë pjesë në vlerësimin e riskut dhe, në këtë rast, duhet:

a) të ndihmojë në identifikimin e risqeve potenciale që ndikojnë në shëndetin e punëmarrësve;

b) të japë mendime për rezultatet e vlerësimit të riskut dhe të propozojë masat që duhen marrë për parandalimin e dëmtimeve në shëndet (çrregullimeve shëndetësore);

c) të propozojë hartimin, përshtatjen dhe zbatimin e programeve promovuese për shëndetin në vendin e punës si dhe përfshirjen e tyre në planveprimin vjetor.”

ii) Pikat 10.3 e 10.6 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“10.3 për të marrë pjesë në analizimin e shkaqeve të sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve të lidhura me punën, për të dhënë analizë të detajuar të faktorëve të riskut në vendin e punës, që kanë shkaktuar çrregullimet shëndetësore në punë, si dhe për të marrë pjesë në analizën e shkaqeve të aksidenteve në punë, kur çrregullimet shëndetësore shërbejnë si shkak i mundshëm i aksidentit në punë;

...

“10.6 për të dhënë mendim për çështjet e përgjithshme të higjienës profesionale, duke përfshirë mjedise të tilla si: vendi i posaçëm për ngrënie, dhomat e zhveshjes, tualetet, vendet punës dhe të çlodhjes dhe mjedise të tjera sociale për punëmarrësit;”

iii) Në pikën 10.8, shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) para fillimit të punës;”

iv) Pikat 10.12 dhe 10.13 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“10.12 për të marrë pjesë në hartimin e planit të evakuimit dhe shpëtimit gjatë situatave emergjente dhe në zbatimin e masave që duhen marrë në situatat me risk të rëndë të menjëhershëm dhe të pashmangshëm që mund të shkaktojnë dëmtime profesionale apo gjendje të tjera shëndetësore, si sëmundje;

10.13. për të koordinuar organizimin e ndihmës së shpejtë dhe kujdesit shëndetësor në

rastet emergjente për viktimat e aksidenteve dhe/ose në rastet urgjente që mund të paraqesin punëmarrësit me sëmundje profesionale;”

v) Pas pikës 10.14 shtohen pikat 10.15, 10.16, 10.17 e 10.18, me këtë përmbajtje:

“10.15. për të asistuar në zbatimin e dokumenteve ligjore e nënligjore lidhur me kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për punëmarrësit, konkretisht, me:

a) përdorimin e sigurt të substancave kimike, kancerogjenë/mutagenë dhe lëndëve biologjike;

b) procedurat që duhen ndjekur në rastet e risqeve të pashmangshme për shëndetin e punëmarrësve dhe ose personave të tjerë të pranishëm në ndërmarrje;

10.16. për të siguruar planifikimin dhe realizimin e programeve për vaksinimin e punëmarrësve për parandalimin e risqeve biologjike të caktuara, sipas përcaktimeve specifike të legjislacionit në fuqi;

10.17. për të koordinuar sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore në ndërmarrje/institucion, duke siguruar:

a) testet dhe ekzaminimet e nevojshme për kontrollin shëndetësor të punëmarrësve, bazuar tek vlerësimi i riskut profesional;

b) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kontrollin fillestar dhe periodik të shëndetit të punëmarrësve;

c) koordinimin e aktiviteteve të kontrollit shëndetësor brenda ndërmarrjes/institucionit apo në institucionet mjekësore të jashtme;

ç) analizën e raporteve të kontrollit shëndetësor në punë për të përcaktuar nëse është e përshtatshme që punëmarrësi të vazhdojë aktivitetet e punës apo të bëhen ndryshimet e nevojshme lidhur me ngarkesën apo përshtatjen e vendit të punës, nëse kërkohet.

10.18. për të bashkëpunuar për formimin e punëmarrësve:

a) përpara fillimit të punës;

b) gjatë transferimit apo ndryshimit të procesit të punës ose vendit të punës;

c) kur prezantohen pajisje të reja apo pajisje të modifikuara pune që shkaktojnë ndryshime në kushtet dhe risqet e punës;

ç) kur përshtatet një teknologji e re në ndërmarrje, që shkaktonte ndryshime në kushtet e punës dhe risqet në punë.”

b) Në pikën 11 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:



i) Në shkronjën “d”, pas fjalës “... aksidenteve ...” shtohen “... dhe sëmundjeve profesionale ...”.

i) Shkronja “g” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“g) të jetë pjesë e procesit të plotësimit të formularit të aksidenteve në punë dhe të përgatitë raportin për sëmundjet profesionale të dyshuara, përmbajtja e të cilave përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë, si dhe të informojë e të rekomandojë punëdhënësin për masat që duhen marrë.”.

c) Fjalja hyrëse e pikës 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Punëdhënësi mban në ndërmarrje dhe vë në dispozicion të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe organeve kompetente një dokument të veçantë, që i bashkëlidhet raportit vjetor të paraqitur nga shërbimi i brendshëm, me përmbajtje, si më poshtë vijon.”.

3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) për çështjet e sigurisë në punë, të ketë formim profesional të përshtatshëm në fushën e inxhinierisë;

b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili:

b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune;

b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;

c) në lidhje me ergonominë:

c.1. të jetë diplomuar në fushën e inxhinierisë apo mjekësisë;

c.2. të jetë i licencuar në fushën përkatëse;

ç) në lidhje me higjienën në punë:

ç.1 të jetë diplomuar në fushën e mjekësisë/inxhinierisë;

ç.2 të jetë i licencuar në fushën përkatëse;

d) në lidhje me aspektet psikosociale të punës:

d.1 të jetë diplomuar në fushën e psikologjisë, sociologjisë apo të mjekësisë së përgjithshme;

d.2 të jetë i licencuar në fushën përkatëse.”.

4. Në kreun V bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Të gjithë punëdhënësit duhet të sigurojnë shërbimet për parandalimin e risqeve dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, sipas dispozitave të këtij vendimi.”.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR

Nr. 101, datë 17.4.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 83, DATË 10.2.2012 “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHITJES SË PRODUKTEVE HIDROKARBURE (NAFTË BRUTO)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 1 të aktit normative nr. 2, datë 18.6.2010 “Për një shtesë në ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, miratuar me ligjin nr. 10298, datë 8.7.2010, të ligjit 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, të ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedimet e shitjes së produkteve hidrokarbure (naftë bruto)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në urdhër, togfjalëshi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me togfjalëshin “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

2. Në pikën 6 fjalja “Në çdo rast, çmimi/ njësi minimal fillestar i shitjes duhet të jetë më i lartë se çmimi i shitjes i programuar nga “Albpetrol”



sh.a. për vitin përkatës.”, zëvendësohet me “Në rast se çmimi/ njësi minimal fillestar i shitjes rezulton më i ulët se çmimi i shitjes i programuar nga “Albpetrol” sh.a., ky çmim miratohet paraprakisht nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë.”.

3. Në pikën 11 togfjalëshi “dokumentit për mospasjen e asnjë detyrimi financiar ndaj shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos”, zëvendësohet me “garancisë bankare të pakushtëzuar, që të garantojë shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura ndaj “Albpetrol” sh.a. kur është rasti”.

4. Pika 18 riformulohet:

“Pagesa nga ofertuesi fitues për sasinë e kontraktuar do të bëhet sipas grafikut të lëvrimit të mallit të rënë dakord midis palëve me transfertë bankare, në *cash*, me letër krediti të parevokueshme, para fillimit të lëvrimit të secilës sasi.

5. Në kontratën tip të shitblerjes neni 4.1 ndryshon: “Veprimet financiare, objekt i kësaj kontrate, do të bëhen nga kontraktuesi në favor të autoritetit shitës “Alpetrol sh.a. Patos.” në bankën _____, dega _____ me nr. Llogarie _____.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË
Damian Gjilknuri

VENDIM

Nr. 57, datë 10.7.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E AMA-S NR. 5, DATË 22.5.2013 “MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR AUTORIZIM”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “P”, pika 16 dhe nenit 25, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, Autoriteti i Mediave Audiovizive:

VENDOSI:

1. Pas pikës 1.1.2 “Masa e pagesës vjetore për autorizimin për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv”, të vendimit nr. 5, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim” të shtohet pika:

1.1.3 Masa e pagesës vjetore për autorizim të Shërbimit *on line*, kur shërbimi mbështetet në Internet, IPTV, OTT, si më poshtë:

- Masa e pagesës vjetore për autorizim për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve përmes IPTV.

Në lekë

Nr.	Popullsia	Deri në 20 programe	Nga 21 programe deri në 40 programe	Mbi 40 programe
1	Deri në 100.000	1,000,000	1,200,000	1,440,000
2	Nga 100.001 deri 200.000	1.200.000	1.440.000	1.730.000
3	Nga 200.001 deri 300.000	1.440.000	1.730.000	2.070.000
4	Nga 300.001 deri 500.000	1.730.000	2.070.000	2.490.000
5	Nga 500.001 deri 700.000	2.070.000	2.490.000	2.980.000
6	Nga 700.001 deri 900.000	2.490.000	2.980.000	3.580.000
7	Nga 900.001 deri 1.100.000	2.980.000	3.580.000	4.300.000
8	Nga 1.100.001 deri 1.300.000	3.580.000	4.300.000	5.160.000
9	Nga 1.300.001 deri 1.500.000	4.300.000	5.160.000	6.190.000
10	Nga 1.500.001 deri 1.700.000	5.160.000	6.190.000	7.430.000
11	Nga 1.700.001 deri 1.900.000	6.190.000	7.430.000	8.910.000
12	Nga 1.900.001 deri 2.100.000	7.430.000	8.910.000	10.700.000
13	Nga 2.100.001 deri 2.300.000	8.910.000	10.700.000	12.840.000
14	Nga 2.300.001 deri 2.500.000	10.700.000	12.840.000	15.400.000
15	Mbi 2.500.000	12.840.000	15.400.000	18.490.000



- Masa e pagesës vjetore për autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv përmes IPTV.

Në lekë

Nr.	Popullsia	Pagesa
1	Deri në 100.000	80,000
2	Nga 100.001 deri 200.000	96.000
3	Nga 200.001 deri 300.000	115.000
4	Nga 300.001 deri 500.000	138.000
5	Nga 500.001 deri 700.000	166.000
6	Nga 700.001 deri 900.000	199.000
7	Nga 900.001 deri 1.100.000	239.000
8	Nga 1.100.001 deri 1.300.000	286.000
9	Nga 1.300.001 deri 1.500.000	344.000
10	Nga 1.500.001 deri 1.700.000	413.000
11	Nga 1.700.001 deri 1.900.000	495.000
12	Nga 1.900.001 deri 2.100.000	594.000
13	Nga 2.100.001 deri 2.300.000	713.000
14	Nga 2.300.001 deri 2.500.000	856.000
15	Mbi 2.500.000	1.027.000

- Masa e pagesës vjetore për autorizim për përsëritjen *online* të shërbimit të programit audioviziv të të tretëve përmes OTT, për vitin e parë është: 1.000.000 lekë

- Masa e pagesës vjetore për autorizim të shërbimit *online* të programit audioviziv përmes OTT, për vitin e parë është: 130.000 lekë

“Pagesa vjetore pas vitit të parë të ushtrimit të aktivitetit për subjektet e autorizuar për shërbim *online* të programit audio/audioviziv të të tretëve përmes OTT ose përsëritjen *online* të shërbimit të programit audio/audioviziv të të tretëve përmes OTT, do të përcaktohet nga AMA i ndarë në fasha sipas numrit të abonentëve. Në të kundërt, pagesa vjetore e miratuar për vitin e parë do të aplikohet edhe për vitet e tjera të ushtrimit të aktivitetit”

- Pika 1.3 në vendimin nr 5, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim” të zëvendësohet me pikën e mëposhtme:

1.3 Pagesat vjetore për autorizimin e shërbimit të programit audioviziv të mbështetur në Internet TV:

1.3.1 Masa e pagesës për autorizimin për ofrimin e shërbimit audioviziv

Programe 200.000 lekë.

1.3.2 Masa e pagesës për autorizimin për ofrimin e shërbimit audio

Programe 30.000 lekë

2. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYETAR
Gentian Sala

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë